



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2021, miratoi këtë

V E N D I M

PËR SHITJEN E AUTOMJETEVE, SI PRONË E LUAJTSHME E KOMUNËS

I.

MIRATOHET Vendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës së Prishtinës.

II.

Shpallja e ankandit publik, të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet për automjetet të cilat janë në pronësi të Komunës.

III.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e automjeteve me informatat përcjellëse për ankandin publik.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Departamenti i Prokurimit Publik.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-144313/21, më 22.07.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

